



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Numri i lëndës: 2024:040286  
Datë: 28.05.2024  
Numri i dokumentit: 05744517

**K.DH.Shk II.nr. 466/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**- Departamenti i Përgjithshëm, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Saranda Bogaj Sheremeti në çështjen përmbartimore të kreditorit “Devolli Logistic System” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810867707 dhe seli në Prishtinë, Zona Industriale, ish Fabrika e Amortizatorëve, kundër debitorit “Korabi Show - 2” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810689375 dhe seli në Vushtrri, rr. “Hamit Hyseni”, p.nr. duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhomat e Shkallës së parë, KPPP.nr.783/23 të datës 18.12.2023, me datë 28.05.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e debitorit “Korabi Show - 2” Sh.P.K., me seli në Vushtrri, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së parë, KPPP.nr. 783/23 të datës 18.12.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale Dhoma e Shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr. 783/23 të datës 18.12.2023, ne dispozitivin e I ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar prapësimi i debitorit “Korabi Show - 2” Sh.P.K, me seli në Vushtrri, ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 570/23, i lejuar me datë 05.05.2023, nga Përmbartuesi Privat Valdrin Beka në dispozitivin II Urdhri

Përmbartimor P.nr. 570/23 i lejuar me datë 05.05.2023, nga Përmbartuesi Privat Valdrin Beka mbetet në fuqi

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës përmbartimore, me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anulohet aktvendimi i Komerciale Dhomat e Shkallës së parë, KPPP.nr. 783/23 të datës 18.12.2023

Kreditori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Devolli Logistic System” Sh.P.K, ka paraqitur propozim për përmbartim P.nr. 570/23 i lejuar me datë 05.05.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin, mbi bazën e dokumenteve të besueshme; 093021036-1, e datës 30.09.2021, ka lejuar Urdhrin Përmbartimor P.nr. 570/23, të datës 05.05.2023, me të cilin është urdhëruar debitori që, në emër të borxhit sipas faturës, kreditorit t’ia paguaj shumën prej EUR 1,364.37 me kamatë ligjore prej 8% nga data kur kërkesa është bërë e arritshme, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore. Debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim duke kundërshtuar urdhrin përmbartimor, me arsyetimin se borxhi në shumë prej EUR 1,364.37 është përmbushur nga ana e debitorit përmes transferit bankar. Ka shtuar se në bazë të faturës mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbartimor nuk është precizuar afati brenda të cilit duhet që të ekzekutohen pagesat për mallin që e merr nga kreditori, sepse kreditori dhe debitori janë dakorduar që pagesat duhet realizuar varësisht nga shitja e mallit, ndërsa në fund të vitit 2023 do të bëhej edhe barazimi final duke përfshirë edhe bonuset që i takojnë debitorit për mallin e shitur te kreditorit. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit si të bazuar, ashtu që urdhri përmbartimor të anulohet. Kreditori në përgjigje në prapësim ka theksuar se kreditori dhe debitori kanë qenë në marrëdhënie bashkëpunimi afarist, ashtu që kreditori e ka furnizuar debitorin me

produkte të Princ Kafe Turke, ashtu siç është pasqyruar edhe në faturën Nr. 093021036-1 të datës 30.09.2021. Më tej, ka theksuar se kreditori para inicimit të procedurës përmbarimore i ka dërguar vërejtje debitorit për mos pagesën e borxhit, mirëpo për shkak të bashkëpunimit ka pritur tash e dy vite që borxhi të përmbushet në mënyrë vullnetare. Ndërsa, ka shtuar se pretendimi i debitorit se ka realizuar pagesa përmes bankës nuk qëndron sepse i njëjti nuk ka ofruar ndonjë provë për të mbështetur një pretendim të tillë. Në fund, ka theksuar se fatura objekt përmbarimi përmban edhe afatin e pagesës dhe se e njëjta është dorëzuar në origjinal, e nënshkruar dhe vulosur nga debitori, andaj i ka propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, ashtu që urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale Dhomat e Shkallës së Parë duke vendosur lidhur me pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit të dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye: Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, “Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: “Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”.

Gjykata Komerciale Dhoma e Shkallës së Parë ka vlerësuar faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përmbarimor nga përmbaruesi privat, duke u bazuar në dokument të besueshëm – Faturës nr. 093021036-1, e datës 30.09.2021, faturë kjo e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm siç kërkohet me nenin 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë emërtuar mallrat me të cilat është shërbyer debitori, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi. Po ashtu, gjykata gjen se e njëjta faturë është lëshuar

me rregull nga ana e kreditorit, ndërsa është pranuar, nënshkruar dhe vulosur nga debitori, andaj debitori ka qenë i njoftuar mbi detyrimin që buron nga kjo faturë.

Dhe rrjedhimisht gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbarimor, i plotëson kushtet në kuptim të nenit 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta i është bashkangjitur propozimit për përmbarim në origjinal.

Dhe duke u bazuar në të lartcekurat, shkalla e parë lidhur me këtë çështje përmbarimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe shkalla e dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Tutje dhoma e shkallës së dytë vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të debitorit Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të se drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarimore.

Mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, kjo Gjykatë vlerëson se dhoma e shkallës së parë ka konstatuar drejtë se fatura si dokument i besueshëm mbi të cilën ishte iniciuar procedura

përmbare, respektivisht është lejuar përmbaremi i plotëson kushtet në mënyrë kumulative qe duhet t'i ketë dokumentin e besueshëm. Në rastin konkret qartë rezulton se Fatura nr. 093021036-1, e datës 30.09.2021, e përmban nënshkrimin e pranuesit i cili është kusht esencial mbi bazën e së cilës dokumenti i besueshëm fiton tipare të përmbareueshmërisë së titullit ekzekutiv, mbi bazën e së cilës mund të konstatohet ekzistimi i detyrimit dhe pranimi si i tillë nga debitori. Gjykata e shkallës së dytë n thekson se me plotësimin e këtij kushti dokumenti i besueshëm mund ta ketë fuqinë e titullit përmbareues sepse rezulton se debitori e ka pranuar detyrimin, prandaj dhe dokumentet e besueshme në raport me dokumentet tjera përmbareimore duhet ta kenë fuqinë e pa kontestuar ekzekutive në mënyrë që procedura përmbareimore të iniciohet përmes këtyre dokumenteve. Një veprim i tillë, për Gjykatën paraqet pranim të faturës dhe detyrimit.

Së këndejmi, edhe gjykata e shkallës së dytë është e qëndrimit të njëjtë juridik se në procedurën përmbareimore organi përmbareues, përfshirë këtu edhe gjykatën që ka kompetencë shqyrtimin e ligjshmërisë së përmbareimit, nuk ka tagër të vlerësojë ligjshmërinë e raportit juridik nga i cili rrjedh dokumenti i besueshëm, statusin e palëve apo detyrimet e ndërsjella mes tyre. Por, organi përmbareues, përfshirë edhe gjykatën e shkallës së parë shqyrton vetëm rregullsinë dhe përshtatshmërinë e dokumentit përmbareues dhe/apo atij të besueshëm, me ç 'rast procedura sipas prapësimi i nënshtrohet vetëm shqyrtimit formal të titullit ekzekutiv.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të se drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbareimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

**Dhoma e shkallës së dytë**

**K. DH.Shk II.nr. 466/24 me datë 28.05.2024**

**Gjyqtarja,  
Saranda Bogaj Sheremeti**